

DRAFTI I
RAPORTIT TE VLERESIMIT TE NDIKIMIT
NE MJEDIS
TE AKTIVITETIT
“Prodhim te profileve te aluminit”



Subjekti: “Shehu-2006” sh.p.k

Vendndodhja: Fshati Ishull Lezhe, Komuna Shengjin

Tirane, 2017

PERMBAJTJA

- ✚ Hyrje
- ✚ Baza ligjore
- ✚ Metodika e vleresimit te mjedisit
- ✚ Objektivat dhe qellimi i VNM-se

1. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT
2. PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI
3. VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS
4. MASAT PER ELEMENIMIN/ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE
5. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

HYRJE

Aktiviteti njerezor qe zhvillohet ne çdo aspekt te vetin, perveç dobesive ne menyre te pashmangshme krijon dhe “produkte” qe ne perfundim mund te sjellin probleme per zhvillimin e qendrueshem te mjedisit. Pavaresisht nga vlerat dhe volumet edhe ne Shqiperi keto probleme vrojtohen dhe shoqeria e shteti kane synuar dhe vazhdojne te organizojne dhe orientojne kete proces. Ndotja e mjedisit nenkupton shkarkimet e cdo lloj mbetje nga pjese te materialeve te ndryshme ne uje , toke, ajer e cila shkakton ose mund te shkaktoje probleme mjedisore te perkoheshme ose te perhershme ne balancen ekologjike te tokes. Se bashku me zhvillimin e madh qe eshte bere ne industri te ndryshme ne menyre te ngjashme me te njejten shpejtesi eshte rritur edhe sasia e mbetjeve nga perdorimi i te mirave materiale. Mbetjet industriale dhe ato urbane te patrajuara , emetimet e gazeve te demshem ne atmosfere, perdorimi i kimikateve te reja pa marre parasysh demet qe mund ti sjellin mjedisit kane sjelle problemet mjedisore me te cilat ne perballemi ne ditet e sotme.

Materiali qe paraqitet trajton ndikimet ne mjedisin fizik dhe human te aktivitetit:

“Prodhim te profileve te aluminit”

BAZA LIGJORE

Relacioni u pergatit ne zbatim te akteve ligjore dhe nenligjore Mjedisore :

- *Ligji Nr.10 431, date 09.06.2011 “ Per Mbrojtjen e Mjedisit”*
- *Ligji nr. 10 448 date 14.07.2011 « Per Lejet e Mjedisit »*
- *Ligji nr.10 440 date 07.07.2011 « Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis »*
- *Urdhrin e ministrit nr. 146 dt. 8.5.2007 ”Per miratimin e listes se kuqe te flores dhe faunes”*
- *Udhezimin nr 8 dt. 27.11.2007 “Per nivelin kufi te zhurmave ne mjedise te caktuara”*
- *Ligji nr. 9010 dt. 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta”*
- *Ligji nr. 10 266 “Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja”*
- *Ligji nr. 10 463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”*
- *Vendim nr.805 date 4.12.2003 « Per miratimin e listes se veprimtarive qe ndikojne ne mjedis per te cilat kerkohet leje mjedisore »*
- *Ligj nr. 8094 date 21.03.1996 « Per largimin publik te mbeturinave »*
- *Udhezim nr.1 date 03.03.2009 « Per detyrat e organeve mjedisore per te siguruar pjesemarrjen e publikut dhe te OJF-ve mjedisore ne procesin e vleresimit te ndikimit ne mjedis »*
- *Udhezim nr.3 date 19.11.2009 ‘Per metodologjine e raportit te VNM’*

- VKM nr.419 date 25.6.2014 « Per miratimin e kerkesave te posacme per shqyrtimin e kerkesave per leje mjedisi te tipave A,B dhe C per transferimin e lejeve nga nje subjekt te tjetri, te kushteve per lejet respektive te mejdisit si dhe rregullave te hollesishme per shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKL-ja ».
- Vendim Nr.13, date 04.01.2013 ” Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis”.

1. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT

➤ Profili i propozuesit

Subjekti “Shehu” sh.p.k eshte regjistruar prane QKR me numer NIPT-i **K58515505H** me administrator Z. **Jashar Shehu** me adrese ne LEZHE BESLIDHJA TE ISH-NN.Me pergatitjen e dokumentacionit perkates subjekti kerkon te pajiset me Leje Mjedisore.

Qellimi i projektit


Qellimi paresor i projektit eshte per prodhimin e duraleve. Gjithashtu ky aktivitet realizon edhe lyerjen e tyre. Prodhimi i duraleve, ben te mundur plotesimin e kerkesave te konsumatoreve, jo vetem te zones perreth por edhe me gjere.

Vendndodhja

Subjekti 'Shehu-2006' do e ushtroje aktivitetin e tij ne fshatin Ishull Lezhe, Komuna Shengjin. Siperfaqja e sheshit te ndertimit eshte 2696 m², largesia nga aksi rrugor 44 m, largesia nga bordura e rruges 40 m.

**PLANIMERTIA E SHESHTI TE NDERITIMIT TE OBJEKTIT :
 GODINE 1 & 2 KAT- (MAGAZINA + AMBIENTE ZYRA +EKSPOZITE) , ne ISHULL LEZHE ;
 Ne Prone te 'SHEHU -2006' sh.p.k. & INVESTITOR : JASHAR SHEHU**

SHK 1:500



POZICIONI KADASTRAL SHK.1:2500
 NR. PASURISE 13741, ZONA KADASTRALE NR.1986



POZICIONI TOPOGRAFIK SHK.1:10000



DISTANCAT NGA KUTIRI I PRONES

VERIU.....	0.5 M
JUGU.....	0.5M
LINDJE.....	0.5 M
PERENDIM.....	32.0 M

MIRATOHET
 PER K R R T-ne e KOMUNES SHENGJIN

KRYETARI



PERGJEGJESI I ZYRES SE URBANISTIKES
 ing. GJYSTE DUSHKU

[Signature]

VENDIMI I KRRT-se nr. 3 dt. 25.02.2011

KONDIÇIONET URBANISTIKE

SIP. E PRONES	2696M2
SIP. E SHESHTI TE NDERITIMIT.....	2096M2
SIP. E NDERITIMIT E NJOLLES	1537M2
SIP. E NDERITIMIT TOTALE.....	1897M2
KOEFICIENTI I SHFRITËZIMIT	57%
LARGESIA NGA AKSI I RRUGES.....	4M
LARGESIA NGA BORDURA E RRUGES	40M

REPUBLIKA E SHQIPERISE
 KOMUNA SHENGJIN

GODINE 1 & 2 KAT- (magazine + zyra + ekspozite),
 ne prone te 'SHEHU-2006' ne ISHULL-LEZHE.

Art. *[Signature]* Nr. L. *[Signature]* Tuzi
 Nr. Ligj. 48787

PLANIMERTIA E SHESHTI TE NDERITIMIT
 shkalla 1:500, lezhe 2011

Numri i njerezve qe do te punesohen dhe nga do te vijne

Zhvillimi i aktivitetit do te kete ndikim pozitive persa i perket nivelit ekonomik te zones sepse do te kete punesim te popullsise vendase . Keta punonjes do te jene te perhershem dhe do te punojne pese dite te javes nga 8 ore ne dite, me nje turn. Punonjesit do te pajisen me uniforma dhe do te instruktohen nga drejtuesi teknik per rregullat teknike gjate proceseve te punes.

Ne menyre rigoroze do zbatohen rregullat e sigurimit teknike dhe te mbrojtjes ne pune.

Projekte te tjera qe do ti vijne ne ndihme aktivitetit

Per zhvillimin e aktivitetit nuk do te kete projekte te tjera sepse sistemi rrugor ekziston,dhe objekti ndodhet buze rruges. Per mbarevajtjen e aktivitetit kjo rruge do te mirembahet nga personeli i shoqerise. Eshte lidhur kontrata me rrjetin e shperndarjes se energjise elektrike per sigurimin e saj si edhe kontrata me ujesjellesin per sigurimin e ujit. Ne rast mungese energjia elektrike do sigurohet permes nje gjeneratori.

Procesi teknologjik

Fuqia punëtore

Gjate zhvillimit te ketij aktiviteti punojne 12 punetore. Kjo shoqeri ka pajisur të gjithë punonjësit që punojnë në sektore me uniformë pune dhe me mjete mbrojtëse ndaj pluhurit dhe faktoreve të tjerë.

Informacion i pergjithshem

E krijuar me misionin e zhvillimit në fushën e aluminit dhe të standartizimit e kësaj fushe, me vizionin për tu bërë lider dhe partner serioz në këtë fushë, vazhdon të punojë pa pushim për realizimin e strategjive te veta. Në qendër të vëmendjes është klienti dhe partnerët. Duke u bazuar gjithmon vetëm në lëndë të para të çertifikuara, duke rritur standartet e produkteve me teknologji bashkohore dhe një staf te kualifikuar, ne garantojmë tek klientet tanë produkte te çertifikuara dhe standarte europiane.

Sektoret e ndare ne reparte sipas proceseve te punes jane:

Furra e ngrohjes se lingotave:

Ne kete furre lingotat ngrohen deri ne temperature 450 0C temperature e mjaftueshme per zbutjen e lingotes. Dhe me pas produkti i lengshem kalon neper forma.

Reparti i prodhimit (presat):

Makinerite qe disponon ky repart jane: prese hidraulike alumini e cila lingoten e zbutur ne varesi te kallepeve e kthen ne profile. Me pas profilet kalojne ne procesin e sharrimit ku priten Keto makineri punojne me energji elektrike dhe gas.

Procesi i materialeve te dala nga perpunimi i prodhim-perpunim aluminit:

Gjate prodhim – perpunimit te aluminit kemi dhe mbetjet e krijuara nga prerjet e ndryshme nga skarcitetet, grumbullohen ne nje ambient grumbullimi dhe me pas shiten,subjekti ne fjale ka nje marreveshje per shitjen e skrapeve te aluminit.

Procesi i lyerjes se profileve

Ne kete proces perdoren lendet e para dhe ndihmese te poshtepermendura:

Profil alumin

Boje puder (rezina polyester)

Gaz i lengshem per djegien ne furre

Polietilen per ambalazhim

Furnizimi i linjes me lende te pare

Lendet e para jane kryesisht profillet e aluminit, reagentet e perdorur gjate trajtimit kimik dhe **s**olucionet e kombinuara te substancave gryese-pastruese dhe veshese-mbushese jane prodhime **t**e firmave greke.

Bojrat puder (rezina polyester te ngopura) jane te firmes italiane Euro Polveri srl.te certifikuara **d**he ne perputhje me standarteve te Komunitetit European .

Procesi i pjekjes

Qellimi i pjekjes eshte fiksimi i bojes puder nepermjet nje polimerizimi te pershpejtuar ne **p**rofilet e sapo lyera. Furrat punojne me kaldaje me gaz te lengshem. Tubacioni i gazin me anen **e** te cilit funizohet kaldaja ndodhet ne nje te ndare te vecante sipas te gjitha rregullave te **s**igurimit teknik.

Ngrohja eshte realizuar me system real dhe me shperndares te nxehtesise per te mbajtur **t**emperature e pjekjes konstante ne te gjitha pikat e brendshme te fures. Furra ne pjesen e **s**iperme eshte e paisur me aspirator.

Paketimi i profileve te lyera te aluminit

Procesi i fundit eshte procesi i paketimit te elementeve me material plastike. Paketimi eshte i **m**ekanizuar dhe i thjesht. Ky process realizon nje ambalazhim uniform me shirita polietileni te **p**roduhuara ne vend, me nje cilesi te larte, rezistente ndaj goditjeve dhe gervishtjeve dhe mjaft te **p**ershtatshem per tu tregtuar dhe transportuar

Procesi materialeve te dala nga perpunimi i prodhim-perpunim aluminit

Gjate prodhim – perpunimit te punes se kompanise kemi dhe mbetjet e krijuara nga tepricat e **l**ingotave, prerjet e ndryshme nga skarcitetet, grumbullohen ne nje ambient te veçante ku dhe me **p**as do te shiten ne subjekte me te cilet Shehu 2006 ka marreveshje.

2. PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI

Trashegimia kulturore

Nga konstatimi ne zone, territori ne studim nuk ndodhet ne distanca te aferta me zonat e mbrojtura nga Instituti i Monumenteve te Kultures . Ne zonen ku ndodhet veprimtaria nuk ka objekte arkitektonike, arkeologjike, kulturore dhe me interesa historike.

Relievi

Relievi i rajonit është i ndryshëm në pjesën perëndimore është fushor me kuotë të ulët mbi nivelin e detit dhe në pjesën lindore është kodrinor – malor në të gjithë zonën e fshatrave të malësisë në një kuotë deri në 700 metra mbi nivelin e detit.

Klima

Në territorin e rajonit mbizotëron klima mesdhetare, ka fusha pjellore, ka kodrina të ulëta, ka vargmale me lartësi mbi 700 m mbi nivelin e detit, ka pyje të dendur. Klima mesdhetare me verë të nxehtë e të thatë e dimër të butë e të freskët, është tipike për zonën fushore e kodrinore. Karakteristike për çdo stinë të vitit janë erërat e forta që fryjnë nga verilindja dhe lindja e drejtohen nga korridoret natyrore, shpatet e maleve. Nga pikëpamja e temperaturave vërehen amplituda të mëdha midis dimrit dhe verës. Temperatura mesatare vjetore është 15,6 gradë celcius, kurse amplituda mesatare është 18 gradë celcius. Reshjet në territorin e rajonit kanë një shpërndarje të pabarabartë. Sasia mesatare e reshjeve është 1350mm në vit. Në zonën malore, kryesisht aty ku bie dëborë në dimër, reshjet janë të pranishme edhe gjatë verës, kurse në zonën kodrinore dhe fushore vera është e thatë. Ditët me diell variojnë nga 220-240 dite, ku mesatarisht gjatë vitit ka deri 3000 orë diell.

Flora dhe Fauna

Bimësia është e shpërndarë sipas kushteve klimatike, duke formuar zona bimësie si zona e shkurreve mesdhetare (zhvillohen shkurret, kryesisht shqopa e mareja), e dushqeve (lisi, gështenja), e ahishteve (ahu) dhe e halorëve (pisha). Duke u nisur sipas vetive të

përdorimit në zonë rriten edhe bimët mjeksore e aromatike që përmbajnë lëndë aktive dhe esenca. Bimët mjekësore që rriten në këtë zonë janë: sherbela, trumza, kamomili, lulebliri, çaj mali, luleshtrydha, lulëkuqja, mullaga. Në zonën tonë rriten edhe bimët spontane foragjere me vlera ushqimore për bagëtinë. Në bimësinë e livadheve dhe kullotave mbizotërojmë graminoret dhe bishtajoret në gjendje të egër si: tërfili, grami, talla, shpatorja. Bimët endemike janë bimë që rriten vetvetiu brenda një territori të caktuar të kufizuar dhe rriten në vartësi të relievit e klimës. Fauna është zhvilluar në varësi të mjedisit. Kështu dallohen fauna tokësore, fauna e ujrave të ëmbla dhe fauna e egër. Shpendë të gjuetisë janë rosa e pata e egër, thëllënxa, karabullakët, çapkat etj. Kafshë të egra që rriten në këtë zonë janë dhelpra, lepuri, ujku, ariu dhe derri i egër.

Gjeologjia dhe dherat

Formësimi gjeologjik i përket periudhës së rrudhosjes alpine këtu e 225-milion vjet më parë. Në këtë strukturë gjeologjike ka shkëmbenj të shumtë sedimentarë, magmatike dhe metamorfikë me rezerva të pasura xeherorësh, bakri, kromi, silici, kuarci, kauline, gurë dekorativ e gëlqerorë, argjila, inerte etj. Me një traditë të hershme në përpunimin e tyre, të mjaftueshme për ngritjen e shumë aktiviteteve industrialo-ekonomike.

3. VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS

Çdo aktivitet që zhvillohet shoqërohet me pasoja dhe ndikime në mjedis, që janë pjesë e atij kompromisi që shoqëria jone ka zgjedhur për të zhvilluar. Megjithatë e rëndësishme është që të kuptohet natyra e këtyre proceseve, forma e shfaqjes së tyre dhe me analitikisht ndikimet e çdo operacioni të kryer.

Vlerësimi i ndikimeve negative nga zbatimi i projektit

Çdo aktivitet i çfarëdo natyre qoftë karakterizohet nga efekte mjedisore negative apo pozitive të cilat sipas natyrës mund të jenë afatshkurter dhe/ose afatgjate, të minimizueshme ose të eliminueshme. Evidentimi i tyre dhe marrja në konsideratë gjatë aktivitetit të ndikimit në mjedis është parakusht për një partneritet në mbrojtje të mjedisit. Funksionimi i aktivitetit shoqërohet me ndikime mjedisore që do të paraqiteshin si me poshte.

Ndikime të mundshme negative në tokë.

Aktiviteti nuk ndikon në strukturën gjeologjike dhe topografike të tokës.

Si është përshkruar në procesin teknologjik ashtu dhe nga fotot shoqeruese të gjithë ambientet e brendshme dhe të jashtme të linjes janë të shtruar dhe të izoluar me se miri.

Ndikimi në rregjimin e ujrave

Nuk kemi ndikime në rregjimin e ujrave pasi uji është përdorur në procesin teknologjik është vetëm ujë ftohes për makineritë dhe nuk është i ndotur nga proceset teknologjike që zhvillohen. Gjithashtu ujrë që dalin nga tualetet do të shkarkojnë në rrjetin e kanalizimeve.

Ndikimet në ajër

Avujt dhe ererat që clirohen nga pjekja e bojës thithen nga aspiratori dhe pasi kalojnë në filtrin e instaluar, clirohen në atmosferë.

Ndikimi i zhurmave në mjedisin rrotull.

Zhurmat në të gjithë mjedisin e linjes (deri në kufijt e saj) janë shumë poshtë niveleve të ekspozitimit profesional dhe të qenësive të saktë në nivelet e ekspozimit urban gjatë ditës 59.8dB(A) dhe në momente të vacanta si zhurma impulsive deri në 65.6dB(A).

Ndikimi në flore dhe faunë.

Nuk pritet ndonjë ndikim negativ kumulativ në flore.

Reagimi i faunës përfaqësohet nga llojet natyrore dhe të kultivuar. Llojet natyrore janë të pakta për një sipërfaqe që zë ky aktivitet, dhe është e vështirë që zhvillimi i tij të prishe një habitat mjedisor. E vetmja rastësi mund të jetë prishja e folezimit nga zhurmat jo të mëdha specifike të aktivitetit (zhurmat e makinave të transportit dhe makinerive të linjes).

Ndikimi i mundshëm negativ në zonat e mbrojtura

Nuk ka asnjë ndikim në zonat natyrore të mbrojtura. Nuk kemi prerje të pemeve apo shkatërrim të vegjetacionit. Aktiviteti në studim nuk bën pjesë në ndonjë zonë të mbrojtur mjedisore, rezervat natyrore, park kombëtar, qendër historike apo në trashëgimi kulturore kombëtare.

Pluhura (lënda e ngurtë)

Nga literatura dhe katalogu i furrës, rezulton se në përgjithësi nivelet e pluhurave të shkarkuara nga furra e ngrohjes nuk duhet të jenë problematike.

Mbetjet e ngurta

Gjatë prodhimit – përpunimit të aluminit kemi dhe mbetjet e krijuara nga prerjet e ndryshme nga skarcitetet, grumbullohen në një ambient grumbullimi ku dhe pas të gjitha mbetjet dergohen për tu shitur në kompani tjetër me të cilën subjekti ka marrëveshje.

4. MASAT PER ELEMENIMIN / ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS

Vleresimi i ndikimeve negative nga zbatimi i projektit

Çdo aktivitet i çfaredo natyre qofte karakterizohet nga efekte mjedisore negative apo pozitive te cilat sipas natyres mund te jene afatshkurter dhe/ose afatgjate, te minimizueshme ose te eliminueshme. Evidentimi i tyre dhe marrja ne konsiderarte gjate aktivitetit te ndikimit ne mjedis eshte parakusht per nje partneritet ne mbrojtje te mjedisit. Funksionimi i aktivitetit shoqerohet me ndikime mjedisore qe do te paraqiteshin si me poshte.

Ndikime te mundshme negative ne toke.

Aktiviteti nuk ndikon ne strukturen gjeologjike dhe topografike te tokes.

Si eshte pershkruar ne procesin teknologjik ashtu dhe nga fotot shoqeruese te gjithë ambientet e brendshme dhe te jashtme te linjes jane te shtruara dhe te izoluara me se miri.

Ndikimi ne rregjimin e ujrave

Nuk kemi ndikime ne rregjimin e ujrave pasi uji eshte perdorur ne procesin teknologjik eshte vetem uje ftohes per makinerite dhe nuk eshte i ndotur nga proceset teknologjike qe zhvillohen. Gjithashtu ujrat qe dalin nga tualetet do te shkarkojne ne rrjetin e kanalizimeve.

Ndikimet ne ajer

Avujt dhe ererat qe clirohen nga pjekja e bojës thithen nga aspiratori dhe pasi kalojne ne filtrin e instaluar, clirohen ne atmosfere.

Ndikimi i zhurmave ne mjedisin rrotull.

Zhurmat ne te gjithë mjediset e linjes (deri ne kufijt e saj) jane shume poshte niveleve te ekspozimit profesional dhe te qene te sakte ne nivelet e ekspozimit urban gjate dites 59.8dB(A) dhe ne momente te vacanta si zhurma impulsive deri ne 65.6dB(A).

Ndikimi ne flore dhe faune.

Nuk pritet ndonje ndikim negative kumulativ ne flore.

Reagimi i faunes perfaqsohet nga llojet natyrore dhe te kultivuar. Llojet natyrore jane te pakta per nje siperfaqe qe ze ky aktivitet, dhe eshte e veshtire qe zhvillimi i tij te prishe nje habitat mjedisor. E vetmja rastesi mund te jete prishja e follenizimit nga zhurmat jo te medha specifike te aktivitetit (zhurmat e makinave te transportit dhe makinerive te linjes).

Ndikimi i mundshëm negativ në zonat e mbrojtura

Nuk ka asnjë ndikim në zonat natyrore të mbrojtura. Nuk kemi prerje të pemeve apo shkatërrim të vegjetacionit. Aktiviteti në studim nuk bën pjesë në ndonjë zonë të mbrojtur mjedisore, rezervat natyrore, park kombëtar, qendër historike apo në trashëgime kulturore kombëtare.

Pluhura (lënda e ngurtë)

Nga literatura dhe katalogu i furrës, rezulton se në përgjithësi nivelet e pluhurave të shkarkuara nga furra e ngrohjes nuk duhet të jenë problematike

Mbetjet e ngurta

Gjate prodhimit – perpunimit të aluminit kemi dhe mbetjet e krijuara nga prerjet e ndryshme nga skarcitetet, grumbullohen në një ambient grumbullimi ku dhe pas të gjitha mbetjet dërgohen për tu shitur në kompani tjetër me të cilën subjekti ka marrëveshje.

✚ Mbrojtja nga aksidentet dhe kushtet në punë

➤ Detyrat e firmës së ndërtimit dhe e subjektit që do të zhvillojë aktivitetin:

- Do të punësohen punonjës që e kanë mbushur moshën për punë .
- Do të punësohen punonjës që kanë eksperiencë të gjatë në punë.
- Punonjësit para fillimit të punës dhe gjatë saj në mënyrë periodike do të instruktohen për rreziqet në punë dhe masat e menjëherë të parandalimit të tyre.
- Punonjësit do të pajisjen me mjete mbrojtëse si maska kundër pluhurave.
- Do të instruktohen punonjësit në mënyrë periodike.

➤ Detyrat e punonjësve:

- Të mos përdoren pije alkoolike para fillimit të punës dhe gjatë kohës së punës.
- Të kontrollojnë gjendjen teknike të pajisjeve në përdorim para fillimit të punës dhe pasi konstatojnë gjendjen e rregullt të tyre fillon punën.
- Kur konstatojnë defekt dhe nuk është në gjendje ta eliminonë ndalon punën dhe ve në dijeni përgjegjës me të afërt.
- Të përdoren mjetet individuale të mbrojtjes gjatë punës.

5. KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME

KONKLUSIONE

- Ky aktivitet prodhues nuk demton habitate dhe nuk prish ekuilibrat biologjike- natyrore.
- Zbatimi i masave të projektit për mbrojtjen e mjedisit dhe ato pak elemente ndotëse që kemi përmendur më sipër që mund të kenë ndikim të vogël në ambient do të eliminohen.
- Mbatja e pastër e mjedisit të zonës së operimit, do të jetë detyrë e përhershme e subjektit për të garantuar një mjedis të pastër në territorin e zonës ku kryhet aktiviteti.
- Janë mbjelle pemë rreth impiantit.
- Për një punë sa më optimale në fabrikë zbatohen rregullat e sigurimit teknik dhe puntoret e manovratorëve njihen me këto rregulla në mënyrë periodike nga drejtuesit teknik të firmës.

REKOMANDIME

- Të merren masa dhe të kryhet rehabilitimi i mjedisit në rastet e ndonjë aksidenti.
- Të kryhet rregullisht kontrolli gjendjes teknike të pajisjeve dhe mjeteve të transportit si dhe të mjeteve të punës.
- Të njihen punonjësit periodikisht me rregullat e sigurimit teknik, si dhe me efektet pluhurave, zhurmave, vibrimet etj në jetën e tyre të përditëshme si dhe të merren masat e duhura për monitorimin në vazhdimësi të tyre me aparatat dhe instrumentet e nevojshme.
- Të bëhet ndërrimi i filtrave sa herë është e nevojshme për funksionimin e mirë të tyre.